ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E VUSHTRRISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **VU644-24-3363-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Ndertimi i rrugeve me kubza betoni (kalldërm) RrPandeli Sotiri Shem Nallbani dhe Hozh Kadri Prishtiba**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Grandelite L.L.C.**
NUI	**811873216**
Adresa	**Rruga Kroi i Bardhë,Lam A Nr.107**
Vendi	**Prishtinë**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**044717171**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Shpresa Rexha**
Adresa elektronike	**grandelite.shpk@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**28.06.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Ndertimi i rrugeve me kubza betoni (kalldërm) RrPandeli Sotiri Shem Nallbani dhe Hozh Kadri Prishtiba

Autoriteti kontraktues – KOMUNA E VUSHTRRISË, me date 04.04.2024 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: Ndertimi i rrugeve me kubza betoni (kalldërm) Rr.Pandeli Sotiri Shem Nallbani dhe Hozh Kadri Prishtina si në vijim:

- **Procedurë e hapur,**
- **Kontrate publike,**
- **Punë, Vlerë e mesme**
- **Vlera e parashikuar e kontratës 170,504.55 euro**
- **Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi me i ulte i tenderit të përgjegjshëm!**

Afati i fundit për dorëzim te tenderëve, ka qen me date 25.04.2024 ora:14:00,

Vendi: Zyra e Prokurimit

Takimi për hapjen e tenderëve ka qen me datë 25.04.2024 ora:14:00 ne platformën elektronikë te prokurimit.

Me datë 18.06.2024 është publikuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues dhe letrat standarde për tenderuesin e suksesshëm dhe te eliminuar, ku shpërblen pa drejtësisht me kontratë GOE "GURËBARDHI" shpk & AL BETON sh.p.k. – KLINË, me çmim dukshëm më të lartë.

Bashkëngjitur ne këtë titull të këtij njoftimi kemi pranuar njoftimin për Letrën standarde te tenderuesit te pa përgjegjshëm (te eliminuar).

Me datë 20.06.2024, kemi paraqitur kërkesën për ri-shqyrtim ne AK ne përputhje me kërkesat e nenit 108/A të LPP-se, (bashkëlidhur gjeni kërkesën për rishqyrtim).

Me datë 24.06.2024, kemi pranuar vendimin e AK për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim, bashkëlidhur vendimi i AK nr.358/2024, i datës 24.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Te pa kënaqur me rezultatin e aktivitetit dhe me vendimin e AK lidhur me vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave, me datë 20.06.2024 brenda afatit ligjorë, kemi paraqitur kërkese për ri-shqyrtim ne pajtim me kërkesat e nenit 108/A, të LPP-se.

(Bashkëlidhur me ketë ankese gjeni edhe kërkesën për ri-shqyrtim te dorëzuar në AK).

Me datë 24.06.2024, kemi pranuar vendimin e AK për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim, bashkëlidhur vendimi i AK nr.358/2024, i datës 24.06.2024.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

I. Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i

ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së) dhe atë;

- Neni 1, Qëllimi, par 1;2 dhe 3;
- Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, par 1;
- Nenit 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1;
- Neni 10, Mjetet për promovimin e Transparencës, par 3 dhe 4;
- Neni 51, Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes, par 1, 2 dhe 3;
- Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, par 1, nen par 1.1 dhe 1.2;
- Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 4, nen par (i) dhe (ii)
- Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, par 1, nen par 1.1
- Neni 108/A, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, par 8, nen par 8.4.

II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi RRPP) dhe atë:

- Neni 97, Shkeljet e rënda, germa (c)

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne vijim do ti trajtojmë pretendimet tona ne ANKESË duke e kundërshtuar :

Vendimin e AK për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim të dt. 24.06.2023;

Vendimi i AK, për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është nxjerrë edhe në shkelje të LPP-se, përkatësisht nenit 108/A, par 8, nen par 8.4 të LPP-se, për faktin se, AK në këtë vendimin nuk i ka shqyrtuar pretendimet ashtu siç është kërkuar nga ankuesi.

Me poshtë gjeni arsyetimin e AK:

Pra, nga ky arsyetim mund të vërtetohet që AK nuk e ka arsyetuar pretendimin tonë ankimor nuk i ka ekzaminuar, vlerësuar dhe administruar provat, por edhe ne ketë vendim ne mënyre të pa drejtë dhe ne kundërshtim me dispozitat e nenit 51 paragrafi 1,2 dhe 3 të LPP-se, aplikon ne mënyre te gabuar kritere shtesë nga NJK dhe DT, sepse po t'i referohemi DT, të pjesa e udhëzimeve, të Kërkesat minimale kualifikuese, pika 9 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, nder të tjera, pika 9.2 citojmë: *"Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe/apo profesionale, operatori ekonomik duhet t'i dorëzojë dokumente dëshmuese të shënuara në FDT".* Ku, në rastin konkret, dokument dëshmues, është vet Aneksi 7.PAJISJET DHE MEKANZIMI I OBLIGUESHË, i DT, ku ne paragrafin e parë te këtij aneksi, AK ka specifikuar që: "Mekanizmi dhe pajisjet e paraqitura në tabelë janë obligative të cilat Operatoret Ekonomik duhet ti kenë në dispozicion".

Pra, bazuar në Aneksin 7, të DT, të përpiluar nga vet AK, ne si GOE, kemi plotësuar në tersi kërkesën e AK, madje kemi ofruar edhe më shumë se sa vet Kërkesa e AK, ku si dëshmi është Aneksi 7 i nënshkruar dhe Vulosur, sepse vet nënshkrimi i aneksit 7 është deklaratë, për me tepër dëshmitë e bashkangjitura aneksit janë argumenti me i fuqishëm që dëshmon se kërkesa e AK është plotësuar në tersi, e ku me ane te aneksit 7 jemi zotuar që i plotësojmë të gjitha kërkesat e AK, madje edhe ma shume.

Është tejet e pa kuptimit dhe e pa arsyeshme të kërkohet edhe një deklaratë shtesë, kur vet AK ka hartuar Aneksin 7 i cili ndërlidhet me dëshminë 4 të FDT-se.

Sepse, i terë qëllimi i kërkesës për rishqyrtim është që t'i veje AK në një pozicion për ti ri-shikuar vendimet e tyre kur janë nxjerrë ne shkelje të dispozitave ligjore, por që, AK në ketë rast, nuk ka ofruar arsyetim apo kundër argument në lidhje me provat tona siç është provë Aneksi 7 i DT dhe dëshmitë e bashkangjitura aneksit me rastin e dorëzimit të DT, por edhe tani ne kërkesën për rishqyrtim.

Madje, përveç aneksit 7, është edhe deklarata nen betim një nga dokumentet me të rëndësishme, me te cilin deklaratë GOE, veçmas dhe secili marrin të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë për çfarëdo dokumenti që ka dorëzuar, ku mund të vërtetohet se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje ne këtë procedure te prokurimit, me te cilën kemi pranuar mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse ne GOE për shkak të pakujdesisë kemi dorëzuar çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Provë 1: Aneksi 7, i DT dhe dëshmitë tjera të bashkëlidhura si (libreza, fatura, DUD-i, etj) .pdf

Provë 2: Deklarata nën betim. Pdf.

Prandaj, është i pa pranueshëm vendimi për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim sepse e ka të njëjtin arsyetim të eliminimit si kurse ne letrën standarde të eliminimit gjatë fazës së vlerësimit dhe, jo arsyetimin në pretendimin tonë të lartë cekur dhe siç kërkohet me dispozitën e nenit 108/A, par 8, nen par 8.4.

Për me tepër AK, përkatësisht zyrtari përgjegjës i prokurimit të AK nuk është konsistent ne zbatim të dispozitave ligjore të LPP-se dhe nuk vepron në mënyre të njëjtë ne rrethana të njëjta nga i njëjti zyrtar dhe po nga i njëjti AK, shih rastin e për tenderin: ***Mirembajtja e rrugeve te rendit te katërt.***, *numër të tenderit:* ***VU644-22-8608-5-2-1 dhe VU644-22-110-521***

Ku në ketë rast, zyrtari në fjalë shpërblen me kontratë një nga OE me çmim me te ulët, por i cili nuk ka plotësuar minimumin e tri nga kriteret e përzgjedhjes të parapara në FDT, por që zyrtari AK arsyetohet, citojmë: ***AK, vlerëson se duke marrë ketë vendim ka marrë parasysh dhe mbrojtjen e parimit "VLERA PËR PARANË".....]***

Kurse në rastin tonë, edhe pse jemi të përgjegjshëm sipas kritereve të përzgjedhjes dhe kemi ofruar dukshëm çmimin me të ulët, për zyrtarin në fjalë, nuk vlejnë të njëjtat parime dhe nuk merret parasysh **mbrojtën e parimit "VLERA PËR PARANË"**, ku në ketë rast, edhe pse dëmtohet rendë buxheti i AK në shumë prej **15,383.85 Euro** apo në përqindje **mbi 10%,** vlejnë parime tjera dhe rregulla tjera.

Pra, në ketë rast kemi shkelje eklatante të dispozitave të nenit 1, 6 dhe 7 të LPP-se, sepse dispozitat e nenit 7 ndër të tjera, garantojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik, kurse neni 6 garanton ku të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ndërsa, neni 1, garanton sigurimi e mënyrës më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike duke qenë i pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike e që ne rastin konkret, ky vendim i pa drejtë i AK, karakterizohet me diskriminim dhe jo transparencë, sepse marrë parasysh qëllimin e normave të mësipërme, është sigurimi i barabarësisë në trajtim të operatorëve ekonomik në mënyre barbaret dhe jo diskriminuese si dhe **Vlerën për paranë**.

Për me tepër me datë 25.06.2024, kemi paraqitur kërkesë për qasje në dokumente të OE të propozuar për kontratë, por që AK, nuk ofron qasje dhe shkel dispozitat e nenit 10, paragrafit 3 dhe 4 të LPP-së, duke na është mohuar të drejtën ligjore për qasje të rregullt dhe pa pengesa, prandaj nga ky veprim/mosveprim i zyrtarit të AK, dëshmon se janë pjekur të gjitha kushtet ligjore për shkelje të nenit 97, shkelje të renda, germa (c), për mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sjellim në vëmendje se barazia para ligjit është një prej te drejtave themelore të garantuar me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës. Më tutje, në bazë të Nenit 21, paragrafit 4 të Kushtetutës, këtë të drejtë kushtetuese e gëzojnë edhe personat juridik, duke përfshirë edhe kompanitë.

Barazia para ligjit, sipas interpretimeve gjyqësore, kërkon që personat (fizik dhe juridik) të kenë trajtim të njëllojtë, kur janë në rrethana të njëjta – siç janë operatorët ekonomik në rastin konkret.

Prandaj, duke marrë parasysh jo konsistencën e zyrtareve përgjegjës të AK, në trajtim të pa drejtë dhe të pa barabartë të zbatimit të dispozitave ligjore nga rasti në rast, mund të konstatohet se me ketë vendim të zyrtareve të AK, përveç shkeljeve të rënda të lartë cekura, janë konsumuar gjithashtu të gjitha elementet e veprës penale, për shkak të dëmit material dhe dëmtimit të qëllimshëm të buxhetit të AK për përfitimeve personale të zyrtareve të AK, ku ne

fazat e ardhshme do t'i ndjekim rrugët ligjore në procedurën penale.

Kurse**, sa i përket njoftimit për eliminimin (Letrën standarde për tenderues te papërgjegjshëm- eleminuar) nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit dhe Njoftimit te Vendimit te AK për rezultatin e tenderit te datës 20.04.2024**.

Qëndrojmë prapa kërkesës për rishqyrtim të dorëzuar në AK të cilën e kemi argumentuar me prova bindëse dhe e cila është pjese e bashkangjitur në ketë ankesë, të cilat u elaboruam me lartë.

Gjithashtu, me anë të kësaj ankese, pretendojmë se AK në kundërshtim te plotë me nenin 56, pika 1, par 1.1 dhe 1.2 dhe nenit 60, pika 1, par 1.1, e LPP-se, shpërblen me Kontratë GOE **"GURËBARDHI" sh.p.k & "AL BETON"sh.p.k.**, **Klinë**, edhe pse oferta financiare e propozuara për dhënie të kontratës ka çmim shumë me të lartë dhe, rrjedhimisht vendimi për rezultatin e tenderit është ne kundërshtim të plotë me kriteret e vlerësimit të parapara në njoftim për kontratë dhe Dosje të tenderit, **sepse kriter i vlerësimit ka qene Oferta e përgjegjshme me çmimin me te ulët me peshim.**

Ku, nëse i referohemi Vendimit te Autoritetit kontraktues rezulton se, çmimi i ofertuar i ofertës së GOE **"Grandelite" sh.p.k & "loT Smart & Green" Shpk dhe "Udha" shpk,** është **147,936.40 €** dhe,është çmimi me i ulte ne raport me çmimin e GOE **"GURËBARDHI" sh.p.k & "AL BETON"sh.p.k.,** Klinë**,** me çmim të propozuar për kontrate ne vlere prej **163,320.25 €**, me që rast, Autoriteti kontraktues me ketë veprim dëmton buxhetin varfër e Republikës se Kosovës dhe te KOMUNËS në veçanti, i cili buxhet përbehet nga taksat e qytetareve te Republikës së Kosovës dhe, **demi material** që do të shkaktohet AK nga veprimet e pa ndërgjegjshme të zyrtareve të AK është ne shume prej **15,383.85 Euro** apo në përqindje **mbi 10% më lartë.**

Prandaj, duke pasur parasysh se, jemi palë me interes juridiko material ne kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-se, jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulët, kërkojmë nga **OSHP-ja**, që Ankesën të trajton në përputhje të plotë me dispozitat e LPP-se dhe rregulloreve në fuqi dhe argumenteve të prezantuara në kërkesën për ri shqyrtim, sepse ka tendencë për abuzim dhe keqpërdorim të buxhetit të Kosovës dhe Komunës në veçanti nga zyrtaret e AK-KOMUNA E VUSHTRRISË

randaj, duke u bazuar në faktet, argumentet, arsyetimet, provat materiale, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që, pas trajtimit të ankesës tonë të nxjerr:

VENDIM

- ✓ Të nxjerrë vendim meritor me të cilin të aprovoj ankesën të bazuar të paraqitur nga **"Udha" shpk & "Grandelite" sh.p.k & "loT Smart & Green" Shpk***;*

- ✓ Të anuloj vendimin e AK për refuzim të kërkesës për rishqyrtim

- ✓ Te anuloj njoftimin B58– **Njoftim mbi vendimin e AK**, për dhënie të kontratës;

- ✓ Te kthej rastin ne **Ri-Vlerësim** dhe vlerësimi të behet sipas kërkesave dhe kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë duke shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik **Udha" shpk & "Grandelite" sh.p.k & "loT Smart & Green" Shpk**

Mbetemi me shpresë se kërkesa për rishqyrtim do të shqyrtohet pozitivisht.

Me respekt,

GOE "Udha" shpk & "Grandelite" sh.p.k & "loT Smart & Green" Shpk

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzime administrative.

Fitimin e humbur përmes padisë dhe, i cili fitim me anë të ekspertizës financiare do të përcaktohet në një fazë tjetër dhe shpenzimet e ankesës.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*